



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:111804

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766720

KF.nr.409/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit, “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyhdi Axhemi avokat, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 10.504.19 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor – Publik, të mbajtur me datë 16.05.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Avokat Zyhdi Axhemi e në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur Krenare Shala, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë, si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.03.2.2/5691; 8094 i datës 24.05.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.06.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit nr. nr.03.2.2/5691; 8094 i datës 24.05.2019, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesa e paditësit si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. nr.03.2.2/5691; 8094 i datës 24.05.2019, dhe Aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr. 01.3.2.2/793 i datës 12.02.2019 dhe të detyrohet dogana e Kosovës në kthimin e mjeteve të paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit mbi shumën e kontestit prej 10.504.19 euro me kamatë vjetore 8% prej ditës së vjeljes deri te dita e ekzekutimit. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se paditësi në mënyrë të rregullt importon derivate të kafesë dhe gjithnjë në transaksionet tregtare ndërkombëtare ka afaruar në mirëbesim dhe i është përmbajtur të gjitha rregullave tregtare dhe të procedurave të tjera që kanë të bëjnë në këtë fushë. Në çështjen juridike tregtare e cila është lëndë e gjykimit në këtë gjykatë pala e paditur Dogana e Kosovës ka sjell vendim të përbashkët, i cili është i lejuar me dispozita respektive e shkelje e përgjithshme sipas palës së paditur paraqiten dis-hamroni të gjoja dokumentacionit të ofruar për

zhdoganim të mallit. Ky mosharmonizim konsiston në ndryshimin e lartësisë së pagesës në mes të pro faturës si dhe faturës e cila e përcjell mallin gjatë transportit deri në doganën e destinimit, dhe kjo dis-harmoni është tejet e pa përfillshme sepse në vlerat e mallit që janë disa dhjetëra mijëra dollar ose euro mund të ketë ndryshim me dhjetë deri në 100 euro. Mirëpo në këtë rast dogana nuk e ka pas parasysh në vazhdimësi me që sipas kontratës pala paditëse tani importuesi është i obliguar me kontratë që avansin ta ushtrojë me rastin e pranimit të pro faturës, andaj me rastin e arritjes së mallit është e mundur të ketë mos harmonizim të pa përfillshim në peshë e gjithë kjo për shkak të tepricës së mallrave në stoqe të depos. Përndryshe kjo dukuri quhet surprisë në gjuhën angleze, e njohur sipas uzansave të tregtisë në botë. Çmimet e nxjerra nga njësi i vlerës së mallrave nuk e ka përfillë parimin që krahasimi i vlerës së produktit në fjalë varet prej vendit të lëvrimin të mallit meqë këto janë vende të ndryshme prej të cilave e ka importuar mallin. Shih për këtë sektori në fjalë pas importimit të mallit ka hyrë në postën elektronike të bursës e jo gjatë kohës kur është importuar malli duke qenë se dallimet në çmime janë të përditshme. Në anën tjetër me rastin e vlerësimit të mallit ky sektor nuk i ka marrë parasysh faktet mbi vjetërsinë e vjeljes së kafes si dhe kualitetin ose cilësinë e mallit i cili shprehet në madhësi të kokrrës dhe vjeljes së freskët të këtij malli. Një pjesë e vlerësimeve ndryshon për shembull prej shteteve eksportuese Vietnamit si dhe të Indisë janë gjete çmime edhe më të ulëta se sa ato të prezantuara gjatë zhdoganimit. Për fund duke shtuar që një pjesë e importit të këtij produkti është i destinuar më tepër për përdorimin e kafesë turke.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 26.10.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi është marrë në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, se vendimi i kontestuar është marrë komfor legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e paditura i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor paditësit për deklaratat e cekura si në aktvendimin kontestues duke përcaktuar vlerë të re doganore, çmimet e nxjerra nga bursa ndërkombëtare Reuters në kohën e blerjes së mallit, ku janë involvuar shpenzimet e transportit sipas UA të QRKS nr. 06/2015 për caktimin e kostos për shpenzimet e transportit të mallrave të importuara. Paditësi ka paraqitur dokumentacion në përpjekje për të provuar se vlera e deklaruar është vlerë e paguar për mallin lëndor, mirëpo në lëndë nuk kemi të bashkangjitur deklaratën eksportuese të shtetit eksportues, madje paditësi pagesat bankare i ka bërë në bazë të pro faturës së mallit, por faturat e mallit kanë vlerë tjetër për arsye të cekura si në ankesë, mirëpo paditësi nuk ka sqaruar se malli nga këto pagesa bankare të realizuara me pro fatura të mallit kur është importuar apo kur do të importohet, me ç'rast paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar. Po ashtu vlen të theksohet se gjatë shqyrtimit të lëndës për deklaratën R 7366/01.03.2021 dogana ka bërë përllogaritjen e ditëve kalendarike dhe ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtimin e DUD të lartcekur është ushtruar jashtë afatit ligjor, pasi që paditësi ka zhdoganuar mallin me dt. 01.03.2021 kurse kërkesën e ka dorëzuar në zyrën administrative me dt 02.04.2021. Andaj ankesa është konsideruar si e parashtruar jashtë afatit ligjor. Lidhur me vlerën e kontestit me parashtruesin e datës 17.05.2024 e ka njoftuar gjykatës se vlera e kontestit është 8.091.44 euro.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 16.05.2024, ka administruar provat si në vijim: Aktvendim 01.3.2.2/5691; 8094 dt 24.05.2021 DUD-at kontestues Faturat 2021-057, 2021-058, 2021-047, 2021-063, 2021-040, 001/2021, Pro faturat: 07/04-2021-002, 07/04-2021-001, 18/03-2021-001, 15/04-2021-001, 26/02-2021-001, 001/2021 Kontratat: 2021-053, 2021-052, 2021-042, 2021-058, 2021-030, 003/2020 CMR Dosjen me të dhëna të disponueshme Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave dt 10.04.2021, 25.03.2021, 15.03.2021 Urdhërpagesat EUR 1 0154852 Transaksionet bankare Kundërshtimet e dt 11.05.2021, 02.04.2021 E-fatura dt 24.02.2021 T1-shat Pro faturë 16.02.2021 (vështirë e lexueshme).

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga DUD-at kontestues të Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori i Pranimit Qendror-Dogana e Kosovës duke vepruar sipas ankesës së datës 02.04.2021 dhe 11.05.2021, e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë “Arena Trade” SHPK me seli në Fushë Kosovë, këtu paditësit, për rishqyrtimin e këtij vendimi. E paditura rivlerësimin e mallit e ka bërë pasi që ka gjetur se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, dhe se Dogana disponon me të dhëna të disponueshme që vlera e mallit lëndor kontestues është më e lartë se vlera e deklaruar nga 5 subjekti, andaj ka caktuar bazë të re doganore bazuar në të dhënat e disponueshme, përkatësisht çmimet të cilat janë marrë nga Reuters si çmimi e të bursës në kohën e blerjes së mallrave, gjithashtu paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transaksionit.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë jo të harmonizuara dhe kundërtënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni.

Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga

ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata konstaton se vlera e faturave dallon nga vlera e profatuave, po ashtu ka dallime edhe në sasinë e mallit ashtu që fatura 2021-058 ka sasinë 11.703.00 kg/net dhe çmim prej 16.384,20 USD, ndërsa fatura ka vlerën 16.800 dhe sasi 12,000.00, pagesa është kryer me çmim nga profaturat, me total 34,377.00 USD, mirëpo malli është i deklaruar me çmimin nga faturat që është 33,661.64

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që Gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109.

Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar administrativ është jo i kompletuar dhe i pa harmonizuar për të konstatuar se vërtet paditësi ka deklaruar vlerën reale të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provat materiale tjera si faturat dhe pro faturat e mallit, transaksionet bankare të Pro Credit Bank të, kontratat e shitblerjes, mirëpo pala paditëse nuk ka arrit të dëshmoj harmonizimin në mes të vlerës së faturës dhe vlerës së pro faturës në kuptim të shumës, pastaj vlerës së faturës në raport me transaksionet bankare ndërkombëtare, pastaj transaksioni bankar në përshkrim të tij përmban numrin e secilës pro faturë dhe jo numrin e faturës për mallit lëndor kontestues, edhe përkundër kësaj transaksionet bankare nuk përputhen në kuptim të shumave më faturat e DUD-ve kontestues, prandaj nga të gjitha këto, Gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktvendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pa pranueshme për zbatim të nenit 33 të KDA-së, pasi që i njëjti është jo-i harmonizuar, dhe pasi që fakti vendimtar për tu dëshmuar se është paguar vlera e deklaruar e mallit lëndor e që është transaksioni bankar, të njëjtat nuk janë të harmonizuara në kuptim të vlerës, sasisë, referencës me faturë dhe vlerë të mallit sikurse në faturat e bashkangjitura.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është përcaktuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nënparagrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”.*

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuar nga paditësi, duke dhënë arsytim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë, siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provoj edhe vlerën e transaksionit, apo vlerës sipas faturës për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar për faturë, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Gjykata vlerëson se aktvendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Gjykata vlerëson se vendimi kontestues, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të cekurat më lart, Gjykata konform nenit 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.409/22 datë 16.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.